



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. 5174 Prot.

Elbasan, më 21.10.2021

Lënda: **Njoftim mbi dëgjesën publike për Rishikimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me Proçedurë të Thjeshtuar, Bashkia Elbasan**

Mbështetur në ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për “Planifikim dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar), neni 13, shkronja “b”, neni 24, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017, “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 26, neni 6, Këshillimi dhe takimi publik, udhëzimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit nr. 1, datë 22.02.2019, për "Hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshëm Vende me procedurë të thjeshtuar";

Bashkia Elbasan do të organizojë – Dëgjesën Publike për Rishikimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me Proçedurë të Thjeshtuar.

Dëgjesa publike që do të zhvillohet ditën e Enjte, më datë 04.11.2021, ora 12:00 në “Teatrin Skampa” Elbasan.

Subjekte private dhe palë të interesuara për bashkëpunim janë të ftuar për të marrë pjesë në diskutim për hartimin përfundimtar të draft propozimit për **rishikimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me Proçedurë të Thjeshtuar**.

Bëjmë me dije se, materiali i propozuar për ndryshim për Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, i vlerësuar dhe i përcjellë në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, sipas detyrimit ligjor, gjendet i publikuar në faqen elektronike zyrtare të Bashkisë Elbasan [www.elbasani.gov.al](http://www.elbasani.gov.al).

Ju Faleminderit



KRYETAR  
Gledian Llatja